**V E N D I M**
**Nr.208, datë 19.4.1994**

# PËR SHTRIRJEN E SIGURIMEVE SHOQËRORE NË PUNONJËSIT E ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE DHE NË PJESËTARËT E TJERË TË FAMILJEVE TË TYRE

Në mbështetje të neneve 2, 6 dhe 9 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Persona ekonomikisht aktivë të vetëpunësuar në bujqësi do të konsiderohen edhe ish-punonjësit e ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-punonjës të tjerët të sektorit shtetëror, të cilët, së bashku me pjesëtarët e tjerë të familjes, kanë marrë tokë në pronësi ose në përdorim.

2. Nga momenti që familja merr tokë në pronësi a në përdorim, mbi personat e familjes shtrihet sigurimi i detyrueshëm.

3. Këta të vetëpunësuar në bujqësi, të siguruar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", përfitojnë të ardhura për lejen e barrëlindjes, shpërblim për lindje fëmije, pensione pleqërie, invaliditeti e familjar dhe pagesa për vdekje.

4. Sigurimet për këta të vetëpunësuar në bujqësi janë të detyrushme për gjithë personat e aftë për punë nga mosha 16 vjeç deri në kohën që plotësojnë moshën për pension pleqërie dhe kur nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë.

5. Të vetëpunësuarit në bujqësi derdhin kontribut vjetor në masën 15 për qind të të ardhurave fikse vjetore 10.800 lekë, e barabartë me 1.620 lekë.

Për rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Mat, Librazhd, Malësi e Madhe, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë masa e kontributit vjetor deri në fund të vitit 1995 do të jetë 9 për qind, e barabartë me 972 lekë.

6. Kontributet derdhen në agjencitë dhe degët e Bankës Tregtare Agrare, dhe, kur nuk ka të tillë, në bashki e komuna, në favor të buxhetit të sigurimeve shoqërore 3 herë në vit, si më poshtë:

- Në muajin prill 10 për qind e kontributit vjetor.
- Në muajin gusht 30 për qind e kontributit vjetor.
- Në muajin nëntor 60 për qind e kontributit vjetor.

Të ardhurat për lejen e barrëlindjes, pensionet, lindjen e fëmijëve dhe për vdekjen, llogariten dhe paguhen nga bashkitë ose komunat për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore, me paraqitjen e dokumenteve përkatëse të përcaktuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

7. Për zbatimin e këtij vendimi Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen në organikë 100 punonjës me një fond page prej 5 milionë lekësh.

8. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të nxjerrin udhëzime për zbatimin e këtij vendimi.

9. Efekte financiare që lindin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen brenda buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të miratuar për vitin 1994.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
**Aleksandër Meksi**